

## PËR HYJIN E MIRËSISË DHE TË SHQIPTARISË

(Tomë Mrijaj, *Monsinjon dr. Zef Oroshi, një jetë e shkrirë për fe dhe atdhe*, New York, U. S. A, 2009)

Libri monografik i publicistit, veprimtarit dhe humanistit Tomë Mrijaj, me titull: “Monsinjon dr. Zef Oroshi, një jetë e shkrirë për fe dhe atdhe” (jetëshkrim), është një lloj enciklopedie gjithëpërfshirëse dhe mjaft kuptimplote, për kontributin e madh atdhetar e fetar të meshtarit, mjeshtrit të letrave, arkitektit të institucioneve fetare, monsinjon dr. Zef Oroshi.

Veprimtaria e tij në afirmimin e çështjes shqiptare në Mirditë - Shqipërinë e Veriut, në Kosovën martire, në Itali dhe në SHBA, ka qenë deri diku e njohur, por jo aq sa ofron kjo vepër monografike studimore. Zef Oroshi, ka qenë jo vetëm udhëheqës shpirtëror, por edhe drejtues i qëndresës popullore antikomuniste për disa muaj me radhë në Shqipëri, kurse në botën e jashtme është angazhuar me tërë qenien për ndërlidhjen e fijeve të mërgatës shqiptare, për organizimin e mobilizimin më të mirë të saj, për kultivimin e fesë, kulturës dhe për rritjen e vetëdijes kombëtare, përgjithësisht.

Autori i librit Tomë Mrijaj, ka qenë vazhdimisht në kontakt me protagonistin kryesor të studimit të tij, prandaj e ka njohur nga afër më mirë se shumë të tjerë. Ai ka përcjellë dhe shënuar në ditarin e tij veprimtarinë kulturore, fetare, letrare e publicistike të monsinjon dr. Zef Oroshit, të cilën ia la trashëgim botës shqiptare, në përgjithësi, dhe mërgatës sonë, në veçanti. Autori e kishte mik shtëpie dhe kumbarë të katër fëmijëve, prandaj ishte vazhdimisht pranë tij, të thuash, në të gjitha aktivitetet e rëndësishme, por dhe në mbrojtjen dhe sigurinë e tij. Në ekspozicion (parashtrim) të veprës, autori përshkruan jetën e Zef Oroshit që nga lindja (më 23 nëntor 1912, pra pesë ditë para Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë), fëmijërinë e rininë, shkollimin në Seminarin Papnor të Shkodrës, ku u dallua me përkushtimin e dashurinë ndaj punës, librit, njohurive të reja etj.

Një rol të madh në edukimin e mbarë, në zgjerimin e horizontit ditor, në përgatitjen dhe formimin e tij intelektual etj., ka luajtur mësuesi patriot, poeti model, gjuhëtari i shquar dhe bariu shpirtëror - dom Ndre Mjeda. Gjatë shkollimit në Shkodër, Zef Oroshi pati fatin të njohë e të marrë mësim edhe nga Homeri shqiptar, atë Gjergj Fishta.

Pas përfundimit të Seminarit me rezultate të larta, shkoi në Itali, ku u regjistrua në Universitetin e Urbinos, në të cilin u diplomua po ashtu me rezultate të shkëlqyera në Teologji dhe Filozofi. Më 1946, abati i Mirditës Frano Gjini e emëroi këshilltar në dioqezën e Mirditës, ku nëpërmjet meshtarisë, veç të tjerash, u përqendrua në zhdukjen e problemit të gjakmarrjes, të kësaj plage të hapur hemorragjike, e cila ende nuk është shëruar në Miritë dhe në Shqipërinë e Veriut dhe vazhdon të kullojë dhembje e gjak. Në pjesën vijuese, autori Tomë Mrijaj na prezanton Mirditën e stërgjyshërve të tij, hedhë dritë në vendlindjen e protagonistit famëmadh, shpalos historinë e saj të dhembshme, por edhe krenare, trajton çështje etnokulturore, duke folur për bajraqtet, doket, zakonet e, me theks të veçantë, për peshën e Kanunit të Lekë Dukagjinit.

Duhet theksuar se sa i përket të dhënave për Mirditën, autori i kompletton me shënime interesante e shteruese të abat imzot Preng Doçit, që është një nga figurat më markante kishtarë e atdhetare të historisë shqiptare. Kundërshtar i komunizmit dhe përpjekja për fe e atdhe Autori ndalet dhe rrëfen, për qëndresën antikomuniste të Grupit Nacional Independent, të Lidhjes së Shkodrës, me kapidan Mark Gjonmarkun, në krye dhe të grupacioneve të tjera antikomuniste, përfaqësuesit e të cilave në Kuvendin Themelues, më 6 nëntor 1946 në Romë morën vendim për krijimin e Bllokut Kombëtar Independent.

Ndër nënshkruesit e procesverbalit të themelimit figurojnë: Kapidani i Mirditës Gjon Marka Gjoni, Ndue Gjonmarkaj, Qazim Mulleti, dr. Xhemil Dino, Nebil Dino, prof. Sotir Kozmo, kapiten Asllan Libohova, Pandeli Papalilo, Luigj Gjergjola, Safa Vlora, Jak Koçi, dr. Eduard Liço, dr. Ismail Vërlaci, prof. Ernest Koliqi, Nexhmedin Vrioni, dr. Xhelal Mitrovica, prof. Namik Resuli, dom Frano Karma, kapiten Jorgji Ruço, kapiten Kapllan Libohova, Theofan Qesari, dr. Kadri Myftiu, dr. Lin Shkreli, prof. Stefan Gazulli.

Në vazhdim, Tomë Mrijaj shkruan për misionin e parë të zbarkimit me avion italian në malet e Mirditës, më 15 shkurt të vitit 1949, të grupit të përbërë nga Ndue Pjetër Gjonmarkaj, Ndue Mëlyshi, Alush Lleshanaku dhe Xhevdet Blloshmi, të cilët ishin stërvitur në Qendrën Amerikane të Zbulimit në periferi të Romës.

Kapidan Ndue Gjonmarkaj nga Mirdita, i biri i kapidan Gjon Markgjonit një antikomunist i njohur, që kishte organizuar Mirditën kundër komunizmit, në fillim të vitit 1944 dhe pas vrasjes së vëllezërve të tij Mark e Llesh Gjonmarkaj, nga Italia u vu në krye të përgatitjes së planeve të zbarkimit në terren (Malet e Mirditës etj.) të grupeve parashutiste antikomuniste. Ai gjithashtu cakton Ndue Pjetër Gjomarkun në krye të forcave profesioniste parashutiste si dhe e emëron me detyrën e n/kryetarit të Nënkomitetit Krahinor të Mirditës, në “Lidhje Kombëtare të Maleve”. Ndue Mëlyshi ishte i biri i bajraktarit të Kthellës, Gjon Mëlyshit, një prej familjeve më të njohura të asaj zone, ku disa prej djemve të atij trangu familjar, kishin shërbyer si ushtarakë të Monarkisë së Zogut. Alush Lleshanaku (ish-profesor në Normalen e Elbasanit), pas vitit 1944, doli në mal dhe u vu në krye të një çete antikomuniste, që vepronte në rrethinat e Elbasanit, Peqinit, e pyjet e Martaneshit. Xhevdet Blloshmi, (ish-kapiten i Monarkisë së Zogut), nga familja e njohur e Blloshmëve të Bërzeshtës së Librazhdit, i cili që në dhjetorin e vitit 1944, kishte dalë në mal në arrati, në krye të grupit të rezistencës antikomuniste, duke vepruar në zonat e Librazhdit e Elbasanit, derisa u arratis nga Shqipëria. Më pas jepen të dhëna shumë interesante të ish-ambasadorit të Shqipërisë në Vatikan, studiuesit dr. Pjetër Pepa, lidhur me përgatitjet për arrestimin e prelatit guximtar, për mbështetjen që i dhanë besimtarët, për ta shpëtuar nga rrethimi i egër komunist, si dhe për bashkimin e tij me grupet e qëndresës atdhetare në malet e Mirditës, me vëllezërit Mark e Llesh Gjonmarku në krye, të cilët u vranë nga forcat e Sigurimit.

Dom Zef Oroshi kishte punuar me grupet antikomuniste të drejtuara asokohe nga Dera e mirënjohur e kapidanëve të Mirditës, deri në vrasjen e dy vëllezërve: kapidan Markut dhe Llesh Gjonmarkut. Në një shkrim me kujtime: “Homazh për monsinjor dr. Zef Oroshin”, autori Bep Kuqani me banim në SHBA, ish i burgosur politik në kohën e regjimit komunist në Shqipëri, kujton: “Për Dom Zef Oroshin, duhet dijtë edhe kjo: Qysh nga dita e arratisjes, që hoqi veladonin e doli në mal, e deri që iku në Jugosllavi, banorët e Mirditës dhe të malësisë së Lezhës e kanë njohë ma fort se prift, si Kryetar të Komitetit të Maleve, si organizator i “Çetave të Shpagimit”, si luftëtar shumë trim dhe si antikomunist i vendosun”.

Në vazhdim, autori i librit, Tomë Mrijaj e përshkruan arratisjen e prelatit guximtar në Jugosllavi në vitin 1952, bashkë me meshtarët: atë Daniel Gjeçaj O.F.M., atë Ambroz Martini O.F.M, dhe dom Nikollë Kimza, të cilët organet e pushtetit jugosllav i vendosin larg kufirit të Shqipërisë, në Mitrovicë. Prej andej, prelati Zef Oroshi, më 3 shkurt 1953

i dërgon një letër kapidan Ndue Gjomarkut, i cili asokohe gjendej në Romë. Përmes saj e informon imtësisht për gjendjen e rëndë në të cilën gjendej Mirdita e Shqipëria para arratisjes së tij. Ai arrin të vlerësojë drejt se si klika komuniste e Tiranës ia kishte dalë që të fuste përçarje ndërmjet toskëve dhe gegëve, se si Shqipëria kishte humbur independencën e saj karshi perandorisë së ferrit të popujve (Bashkimit Sovjetik) etj. Është mjaft prekës fragmenti i letrës, ku shkruan për mungesën e gjërave elementare ushqimore, për vdekjet e njerëzve nga torturat, nga uria, nga sëmundjet etj.

Krahas kësaj, letërshkruesi shënonte se në Tiranë e kishin lartësuar Stalinin, duke i ngritur pesë monumente. Kështu, thekson ai, ishte vepruar edhe në qytetet kryesore të Shqipërisë. Një fakt tjetër shqetësues dhe i dhembshëm ishte se në shkolla mësimi zhvillohej sipas programeve të pedagogjisë sovjetike; ndërsa me dekretligjin e gushtit të vitit 1952, ndaloheshin të gjitha librat e shtypur para vitit 1944, si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhët e huaja.

Në vazhdim jepen të dhëna për shtypjen fetare dhe qëndresën e kishës katolike në Mirditë, duke sqaruar pse qëndresa e saj ishte aq e fuqishme. Kemi këtu të dhëna për riorganizimin e Nënkomitetit të Mirditës, që drejtohej nga Llesh Gjonmarkaj dhe për ndërlidhjet e tij me udhëheqësit e krahinave të tjera. Në fund të letrës evidentohet terrori e dhuna e paparë, por edhe qëndresa spartane e luftëtarëve të lirisë. Me doktoratë të filozofisë dhe teologjisë në Romë drejt Amerikës Në vitin 1954, dom Zef Oroshi bashkë me meshtarët atë Daniel Gjeçaj dhe dom Nikollë Kimza, me garancinë e kapedanit të Mirditës, Gjon Marka Gjoni dhe djalit të tij, Ndue Gjonmarku, shkuan në Itali. Atje, sipas autorit Tomë Mrijaj, dom Zefi ndoqi studimet në Universitetin Katolik “Angelicum”, duke i finalizuar ato me mbrojtje të tezës së doktoratës, me notën më të lartë. Gjatë qëndrimit në Romë, krahas meshtarisë, filloi të bashkëpunojë me botuesit e “Shejzave” prof. Ernest Koliqin dhe redaktorin prof. Martin Camajn. Në Romë përktheu veprën “Shkrimi i Shenjtë, Katër Ungjijtë dhe punët e Apostujve”, të cilën ia kushtoi mësuesit të paharruar dom Ndre Mjeda. Një kapitull i veçantë i monografisë së Tomë Mrijajt për atdhetarin dom Zef Oroshi, është ai që pasqyron jetën dhe veprimtarinë e tij në SHBA. Në vitin 1961, dom Zef Oroshi shkon në Amerikë. Fillimisht vendoset në Boston, ku qëndron disa muaj dhe njihet më për së afërmi me “kryeqytetin” e shqiptarëve të Amerikës. Këtu viziton shpesh imzot Fan S. Nolin, me të cilin ka pasur kontakte edhe më parë.

Monsinjori e pohonte me mburrje se peshkopi Fan Stilian Noli ishte një patriot i vërtetë, se gjatë takimeve të shpeshta ekumenike kishin shfaqur idenë e afrimit të Kishës Ortodokse Shqiptare me Kishën Katolike Shqiptare, por pas vdekjes së peshkop Nolit (më 13 mars të vitit 1965), aktiviteti që ndërmoren bashkësitë fetare të krishtera shqiptare me qëllim të pajtimit, të bashkëpunimit dhe të afrimit të tyre, mbeti vetëm një ide, që koha e harroi dhe zbehu ngadalë.

Angazhimi në çështje atdhetare, fetare, kulturore dhe artistike

Një punë të madhe ka bërë monsinjor Oroshi sidomos nga viti 1962, kur u shpërngul në Nju Jork, ku themeloi “Lidhjen Katolike Shqiptaro-Amerikane” dhe më vonë gjithashtu themeloi dhe drejtoi revistën “Jeta Katholike Shqiptare”, që doli për 12 vjet rresht (1966-1978 dhe sot vijon me këtë emër). Si bazë mbështetëse për pasqyrimin e kësaj veprimtarie dhe angazhimeve të tëra shumëdimensionale, studiuesi Tomë Mrijaj, i ka shërbyer një vështrim i prof. Zef Nekës për revistën “Jeta Katholike Shqiptare” dhe për rolin e madh të imzot Zef Oroshit si drejtor i saj. Nga këto shënime del se, pos çështjeve fetare, ai i ka mbajtur në dijeni të plotë lexuesit mbi veprimtarinë e shenjtores për së gjalli, Nënës sonë të madhe Tereze Bojaxhiu.

Historikisht janë trajtuar tema mbi Gjergj Kastriotin-Skënderbeun, sidomos me rastin 500-vjetorit të vdekjes së tij, mbi arbëreshët, ngritjen e flamurit, mbi përvjetorët e figurave të patriotëve, letrarëve, klerikëve të shquar etj. Sipas publicistit Mrijaj, dr. Zef Oroshi ishte i mirëpritur edhe në qendrat fetare islame. Duke qenë një atdhetar i flaktë e vizionar, njeri i afrueshëm e racional, ai ka bashkëpunuar ngushtë me drejtuesit e komunitetit mysliman, si: imam Sali Myftinë, kryetar i fesë islame në Detroit dhe Kanada, imam Vehbi Ismaili, imam Isa Hoxhën, hoxhë Hamit Perollin, sheh Halilin, baba Rexhepin, kryetar i Teqesë Bektashiane në Detroit etj. Pra, ai punoi pa u kursyer për kultivimin e traditës e harmonisë fetare shekullore, për mbjelljen e dashurisë e respektit për njëri-tjetrin. Ky përcaktim dëshmohet edhe me faktin, se monsinjori mendjendritur e bamirës, bëri fushatë për grumbullimin e mjeteve financiare, për ndërtimin e qendrave katolike e islame.

Një vend të spikatur autori Tomë Mrijaj i kushton angazhimeve të monsinjor Zef Oroshit kundër regjimit komunist të Enver Hoxhës. Meshtari shqiptar, nëpërmjet takimeve me miqtë amerikanë si kongresmeni Mario Biaggi<sup>1</sup> dhe shumë senatorë dhe kongresmenë të tjerë, e kanë ndihmuar mons. Oroshin për çdo ankesë që ai ka paraqitur për komunitetin shqiptaro-amerikan dhe çështjen shqiptare në përgjithësi, si

për lirinë e fesë dhe kundër komunizmit në Shqipëri dhe çështjen e lirisë së Kosovës, kundër pushtuesve serbë.

Ai gjithashtu, gjatë tubimeve e protestave para Selisë së OKB-së, ka stigmatizuar pushtetin dhe ideologjinë komuniste, që e kishin sjellë Shqipërinë dhe popullin shqiptar në një gjendje të mjerueshme ekonomike, arsimore, shëndetësore etj., ku mbretëronte zhgënjimi e po perëndonte shpresa, për një të nesërme më të mirë. Aty evidentohet edhe reagimi i Vatikanit dhe i agjencive prestigjioze të lajmeve italiane, austriake, amerikane, angleze etj., për dënimin me pushkatim të dom Shtjefën Kurtit, të cilat protestuan fuqishëm ndaj këtij akti terrorist. Evidentohet raporti i Misionit Shqiptar pranë OKB-së ku theksohet: “Më datën 1 prill 1973, pranë Selisë së Misionit Shqiptar në Nju Jork, prifti Zef Çoku (Oroshi) organizoi demonstratë në shenjë proteste, duke shfrytëzuar si pretekst vrasjen e priftit Shjefën Kurti dhe “persekutimet fetare në Shqipëri”. Për këtë veprimtari antikomuniste nëna, vëllezërit dhe motra e monsinjorit në Shqipëri e kishin pësuar shumë rënd nga regjimi diktatorial i Enver Hoxhës.

Përkundër këtij preokupimi parësor, prifti atdhetar gjente kohë për t’u kujdesur edhe për gjendjen e punëtorëve shqiptarë të krahut në Amerikë. Ishte mjaft aktiv edhe në sferat kulturore e letrare, duke marrë pjesë në Këshillin Drejtues të “Vatrës”; angazhohej që të mbante gjallë ndjenjat kombëtare e fetare; këshillonte rininë shqiptare të ecte me kohën, angazhohej për ruajtjen e mirëbesimit e ndërlidhjes midis gjeneratave, ose prindërve e fëmijëve të tyre etj.

Për të gjitha këto dhe sferat e tjera të veprimtarisë atdhetare e fetare, monsinjor Zef Oroshi konsiderohej si bari i urtë e atdhetar i zjarrtë. Ai ka marrë pjesë edhe në përkujtimin e 25-vjetorit të persekutimit të Kishës Katolike Shqiptare, më 5 mars të vitit 1972 në Nju Jork. Gjatë këtij aktiviteti inxhinier Xhafer Deva, kryetar i Lidhjes së Prizrenit në Mërgim, përkujtoi virtytet dhe karakterin e martirit patër Anton Harapi O.F.M., të cilin i ngarkuari gjerman për punët e Ballkanit, gjatë Luftës së Dytë Botërore, Herman Neubauer, e vlerësonte si figurë poliedrike, patriot stoik, filozof, orator dhe shkrimtar të spikatur shqiptar.

Është me shumë interes të përmendim faktin se si imzot Oroshi mori pjesë dhe bekoj martesën e Leka Zogut II, i biri i Ahmet Zogut (në Spanjë) më 10 tetor 1975, në prani të 1 500 pjesëmarrësve, përfshirë këtu rreth 100 personalitete të huaja: ambasadorë, princër, mbretër, dukë e dukësha. Ai, në krye të Lidhjes Katolike Shqiptare, më 26 tetor 1975 organizoi një mbrëmje kulturore shoqërore, kushtuar përkujtimit të botimit

të veprës së parë letrare në prozë në gjuhën shqipe të imzot Pjetër Bogdanit.

### **Nderimi për Nënë Terezë dhe personalitete të tjera kombëtare**

Një vend mjaft të dukshëm, autori Mrijaj i kushton ftesës dhe mikpritjes së Nënës Terezë që i bëri monsinjor dr. Zef Oroshi në Kishën Shqiptare në Nju Jork, më 25 korrik 1976, dhe efekti që pati prania e saj në mesin e shqiptarëve në Amerikë. Autori, në vazhdim shkruan se si më 24 shtator 1978, bëhet inaugurimi i Kishës Katolike Shqiptare në Bronks, N. Y., të ndërtuar me ndihmat e shqiptarëve të këtij qyteti të madh, me çka u përmbyll një periudhë e lavdishme veprimtarie, për mërgimtarët katolikë shqiptarë në Amerikë. Në vitet në vazhdim, përkatësisht në vitin 1982, monsinjor dr. Zef Oroshi ishte i ftuar nga Universiteti “Santa Clara” në Kaliforni, ku celebroi një meshë për nder të martirëve shqiptarë ndër shekuj. Autori Tomë Mrijaj, shkruan edhe për takimin e monsinjor dr. Oroshit me dr. Anthoni Athanasin në Boston, në maj të vitit 1982, ku bashkë me të ka qenë edhe prof. Zef Neka.

Kështu, autori, duke qenë pranë tij në momentet më të rëndësishme të veprimtarisë, ka arritur të japë momente mjaft interesante dhe nganjëherë shumë prekëse veçanërisht kur monsinjori merrte lajme të këqija për familjarët e tij në Shqipëri. Për fat të keq, këso lajmesh pikëlluese merrte shpesh jo vetëm ai, por edhe emigrantë të tjerë shqiptarë. Vdekja e vëllezërve, Prendit dhe Ndues, motrës Luke ishte kulmi i tyre tmerrues. Janë me shumë interes edhe pjesët ku flitet për nderimin që monsinjori i bëri figurës madhore të Abaz Kupit pas vdekjes. Ai u lut për të jo vetëm gjatë ceremonisë mortore, por edhe dy vjet rresht pranë varrit të tij.

Autori i librit ishte i pranishëm gjatë vizitës që monsinjor dr. Zef Oroshi i bëri Memorialit të shërbëtorit të kombit, Mit’hat Frashërit, duke shprehur kështu respektin e thellë për atdhetarin e shquar. Ai, duke njohur personalitetin, angazhimin atdhetar, kulturor e politik, shpirtin e dëlirë të gjeniut të kombit, ka bërë një paraqitje shteruese për jetën dhe veprën e tij. Është shumë e njerëzishme dhe kuptimplote pasqyrimi i raporteve tepër të afërta të monsinjor dr. Zef Oroshit me Tomë Mrijajn, autorin e librit kushtuar këtij personaliteti të rëndësishëm. Disa tablo me tema të ndryshme pasqyruese: “Si u bëmë kumbarë”, “Ikja dhe ardhja e një engjëlli” etj., e plotësojnë dhe begatojnë gjithnjë e më mirë kontributin e monsinjorit, që ka dhënë në disa fusha të veprimtarisë së tij.

Në një tablo pasqyrohet edhe profecia e admirueshme e monsinjor Zefit, e cila më ka bërë përshtypje të jashtëzakonshme, duke ma kthyer kujtesën në një kohë mjaft të largët, në gjysmën e dytë të viteve '60, kur punoja si mësimdhënës në shkollën tetëvjeçare të Gurrakocit. Kjo ma kujtoi tragjedinë e familjes së Jakup Salih Gjedisë, një emigranti nga Bytyçi i Tropojës, i vendosur në fshatin Veriq të Istogut, të cilit malazezët ia patën therur djalin, Hilmiun (1954-1969), i cili ishte nxënës i imi ndër më të mirët, një djalë i zgjuar dhe shumë i edukuar.

Derisa po e lexoja këtë pjesë të librit, sakaq para sysh m'u shfaq Hilmiu i zbehtë në fytyrë e me sy gjysmë të perënduar. E kam parë me sytë e mi se si shuhej në duart e prindërve të tij, Gjylës dhe Jakupit në qendër të Gurrakocit, teksa po prisnin ndonjë mjet për ta dërguar sa më shpejt në spitalin e Pejës. Kjo vrasje makabre pati pikëlluar nxënësit, mësimdhënësit, madje edhe të gjithë banorët e Podgurit e më gjerë. Duke parë solidaritetin kaq të madh dhe bujarinë e fisnikërinë e njerëzve të këtij mjedisi, Jakup Salih Gjedia dhe familja e tij e kthyen dhembjen në forcë, ndjellakeqësinë (pesimizmin) në ndjellamirësi (optimizëm), zhgënjimin në shpresë se në jetë shpejt do t'u vijë një fëmijë tjetër që do të marrë kuptimin e vazhdimësisë, pavdekësisë së fisit të tyre, që do të jetë sinonim i pathyeshmërisë e qëndresës së përjetshme në këto troje. Kështu, po atë vit familjes Gjedia ia fali Zoti një djalë. U gëzuan jo vetëm njerëzit, por edhe trarët e shtëpisë...

Gjithashtu është shumë prekëse edhe përshkrimi i tragjedisë tjetër, që kishte përjetuar familja Gjedia në Amerikë. Në vitin 1972, ajo është shpërngulur nga Kosova në Itali, për të vazhduar një vit më vonë rrugëtimin për në SHBA. Atje, më 28. 09. 1981, humbi jetën Hilmiu (emër i përtërirë), nipi i vogël i Jakupit e djali i Azemit. Pikëllimi ishte tepër i madh, sepse ishte i vetmi vëlla i pesë motrave. Shumë njerëz, në mesin e tyre edhe monsinjor Zefi bashkë me autorin e kësaj vepre, Tomë Mrijajn, morën pjesë në ceremoninë mortore për ta ngushëlluar dhe për t'i dhënë forcë qëndrueshmërie familjes së Azem Gjedisë, që ta përballojë dhembjen e madhe. Lidhur me këtë, autori shkruan: "Me këtë rast Monsinjori pasi qëndroi para kufomës dhe dha uratën e përshpirtshme, iu drejtua të pranishmëve: "Me erdhi shumë keq për fatkeqësinë e papritun". Dhe pa me sy Azemin, babanë e të ndjerit. "Kjo ka qenë vullnesa e Zotit, por e ndiej thellë në zemrën time se s'shepti Zoti do ta gëzojë familjen me një djalë!"

Mbas një viti parashikimi i imzot Oroshit u bë realitet. Vullneti i Zotit vendosi që kjo familje atdhetare të shtohet më një djalë. Shumë të pranishëm, që e kishin dëgjuar lutjen e bariut shpirtbardhë e zemërluan, thoshin: “MonsinJOR Zef Oroshi ka shumë parandjenjë. Atë që ia ndjen zemra, Zoti ia bën realitet!” Në vazhdim përshkruhet momenti kur monsinqori me autorin u gjendën përpara shtëpisë së amshimit, ku ishte skalitur rrasa e varrit të tij, me fjalët si tek rrasa e Moisiut.

Autori, duke qenë një mik i shpirtit të monsinqor dr. Zef Oroshit dhe njeri shumë human me zemër të bardhë, i ka qëndruar si gardian mbrojtës, madje edhe kur i adhuruari i tij kaloi në amshim, ai luajti rolin kryesor në organizimin e ceremonisë mortore. Në vitin 1985, del në pension, me çka, sipas autorit, monsinqor Oroshi ishte i qetë për realizimin e qëllimit të popullit të vet në Amerikë. Me daljen në pension të imzot Oroshit, vendi i tij u zëvendësua nga dom Rrok Mirdita.

Në këtë libër, lexuesi gjen edhe një mal me të dhëna plotësuese për jetën dhe veprën e monsinqor dr. Zef Oroshit dhe të miqve të tij të shumtë, si: prof. Rexhep Krasniqi, prof. Luan Gashi, gazetares Nexhmie Zajmi etj. Këto të dhëna kompletohen edhe me shënime (referenca të kompletuara përmbajtjesore) që do t’u shërbejnë edhe studiuesve të tjerë. Autori e ka kompletuar me mjeshtëri figurën dhe veprimtarinë e protagonistit kryesor të tij, duke portretizuar edhe disa prelatë të tjerë të shquar, si: imzot Vinçenc Prennushi, të cilin e vlerëson si shërbëtor të devotshëm të fesë dhe si njohës të thellë të letërsisë, pastaj figurën e imzot Rrok Mirditës, që shërbeu dhe u ngrit në Tivarin tonë, në skajin më verior të Arbërisë.

Libri, pasqyron në detaje ringjalljen e hierarkisë së kishës katolike në Shqipëri, Kosovë dhe në trevat e tjera etnike. Kjo kompletohet me jetëshkrimet e imzot Rrok Mirditës, atë Andrea Nargajt O.F.M., dom Lazër Sheldisë, dom Pjetër Popajt dhe dom Nikolin Përgjinit.

Në këtë vepër, lexuesi has në të dhëna shtesë për imzot dr. Oroshin, për revistën “Jeta Katolike Shqiptare” etj. Ka këtu edhe shkrime të dr. Rexhep Krasniqit, për gjendjen e bashkësisë së mërgimit politik shqiptar në Nju Jork (1967) dhe për inaugurimin e Kishës së re moderne të “Zojës së Këshillit të Mirë”, më 24 shtator 1974, që është një ngjarje me rëndësi të madhe jo vetëm për bashkësinë katolike shqiptare amerikane të Nju Jorkut, por edhe për mbarë mërgimin politik shqiptar në Amerikë. Autori Tomë Mrijaj inkorporon (përfshinë) në libër edhe kumtesën e tij shkencore me titull: “Me zemër të madhe për Atdheun”, paraqitur në Sesionin shkencor në Prizren, më 26-27 nëntor 2004, pastaj “Kujtimet e hidhura nuk fshihen...” dhe “Respekt e mirënjohje për mësuesin Mjedja”.

E gjithë kësaj duhet shtuar edhe intervista me publicistin veteran, Tonin Mirakaj, me titull: “Imzot Zef Oroshi, themelues e drejtues i shtypit katolik shqiptar në Amerikë” etj.

### **Publicist dhe letërkëmbyes (epistolar)**

Figura poliedrike e monsinjor Oroshit kompletohet edhe me kontributet e tij në publicistikë, të cilat pasqyrohen nëpërmjet artikujve: “Nji oazë rilindjeje kombëtare në diasporë” pastaj “Fiket Ernest Koliqi, nji pishtar i letërsisë e i kulturës shqiptare”, “Përgatitja dhe prodhimet letrare”, përkthime marrë nga revista “Shejzat”. Autori i librit ka mishëruar a trupëzuar (inkorporuar) këtu edhe shkrimin nekrologjik (përkujtesën) e monsinjor dr. Zef Oroshit “Vdiq profesor Karl Gurakuqi, veteran i arsimit shqiptar” dhe shënime të tjera si “Shtëpia e Zotit dhe Dera e Qiellës”, “Bashkatdhetarë Shqiptarë” etj.

Autori Tomë Mrijaj e kompletion librin edhe me një fragment të novelës “Çohaja” të monsinjorit, e cila është botuar e plotë në revistën “Shejzat”. Në vazhdim autori evidenton përmbajtjen e letërkëmbimeve të monsinjor dr. Zef Oroshit me personalitete të shquara kishtarë shqiptare e amerikane dhe me veprimtarë të komunitetit shqiptar, përfshirë këtu edhe Halim Begenë, Xhevat Kallajxhiun, Rrok Malokin, Marash Ndoc Shkrelin, imam Isa Hoxhën, episkop Stefan Laskon, prof. Rexhep Krasniqin, Baba Rexhepin etj.

Një pjesë me shumë vlerë e librit është edhe kapitulli: “Titujt e shkrime të botuara nga imzot dr. Zef Oroshi”, të cilat pasqyrojnë ngjarjet historike që lidhen me këtë figurë madhore fetare e kombëtare. Aty janë përfshirë artikuj të botuar në organe të ndryshme të shtypit shqiptar dhe të huaj në Amerikë dhe jashtë saj. Autori, ka botuar edhe shumë materiale dhe artikuj, që monsinjori i ka shkruar ose i ka lënë në dorëshkrim amanet atij personalisht dhe personave të ndryshëm me të cilët kishte lidhje miqësore e intelektuale. Të gjithë këta u treguan të gatshëm t’i publikojnë këto materiale duke mundësuar kështu që të lexohen dhe të ruhen si thesare të krijimtarisë shumëdimensionale të meshtarit të papërsëritshëm. Në fund, si zakonisht, jepet një listë e literaturës së pasur, që është bazë mbështetëse e këtij libri enciklopedik e me shumë vlerë.

Mund të përfundojmë se, autori i këtij libri dhe miku im me besë të fortë ia ka dalë që protagonistin e tij, këtë personalitet të shquar të jetës kishtarë, intelektuale e atdhetare ta bëjë shumë të njohur, jo vetëm për qarqet shkencore, por edhe për rrethin e gjerë të lexuesve.

---

Studiuesi, publicisti dhe veprimtari i palodhur i çështjes kombëtare Tomë Mrijaj e ka arritur këtë edhe falë kualiteteve të veta humane e atdhetare, të trashëguara nga rrënjët e moçme të trungut shqiptar, që të ndihmojë e t'i gjenden pranë mikut dhe sidomos atyre që tërë jetën ia kanë kushtuar atdheut, kombit, njerëzve të fisit dhe të tjerëve.

**Muhamet SHATRI**